



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:040054  
Datë: 10.01.2019  
Numri i dokumentit: 00202405

**P.nr.987/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me praktikanten Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.A, për shkak të veprës penale posedimi paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzave së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr. 1394-3/2018 të dt.28.08.2018, PP/II. nr. 1611-10/2018 të dt.23.08.2018 dhe PP/II.nr.1448-10/2018 të dt. 08.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Mimoza Syla Hyseni dhe të pandehurit L.A, me datë 26.12.2018 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 09.01.2018 përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **L.A** nga Ferizaj rr..... nr....., i lindur më .... në Prishtinë me numër personal ....., nga i ati ....dhe nëna ..... e gjinisë ..... ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, punon si punëtor fizik, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **ËSHTË FAJTOR**

1 Me datë 21.06.2018, rreth orës 15.00, në Ferizaj, gjatë kontrollës nga oficeri në qendrën e ndalimit në Ferizaj është gjetur dhe konfiskuar substanca psikotrope e llojit marihuan, në peshë prej 2.30g të cilën e posedonte pa autorizim.

2 Me datë 19.06.2018, rreth orës 17.30, në stacionin policor në Ferizaj, pasi kishte shkuar në polici për një rast gjatë kontrollit të tij në gjep e kishte gjetur një sasi të substancës narkotike me peshë prej 1.21g, të cilën substancë narkotike i pandehuri e ka poseduar pa autorizim, pastaj i është konfiskuar nga ana e policisë.

3 Me datë 27.05.2017 ,rreth orës 00.30 në Ferizaj në rrugën “Ahmet Kaqiku”, patrolla e policisë kanë tentuar ta ndalin veturën e tipit “Hunday Matrix” me targa ..... të cilën e drejtonte i pandehuri i cili nuk është ndaluar, patrolla policore i është vënë pas dhe pasi kanë arritur ta lokalizojnë, pas kontrollës të njëjtin iu është gjetur një cigare e mbështjellur – substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë 0.70g të cilën substancë narkotike i pandehuri e ka poseduar pa autorizim, pastaj iu është konfiskuar nga ana e policisë.

**- me të cilën në vazhdim ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.**

**Andaj në bazë të dispozitave të nenit 275 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e**

## **G J Y K O N**

**ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 6/GJASHTË/MUAJ burgim ,i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.**

**Konform nenit 273 par.5 të KPRK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë 4.21 gram.**

**DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 400/ katër qind/€, të cilin dënim do ta paguaj në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**

**Nëse dënimi i zëvendësuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPK-ës do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 € do të vuaj nga një ditë burgimi.**

**Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njzet /€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.**

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj sipas aktakuzave të evidentuar si PP/II.nr. 1394-3/2018 të dt.28.08.2018, PP/II. nr. 1611-10/2018 të dt.23.08.2018 dhe PP/II.nr.1448-10/2018 të dt. 08.08.2018, ka paraqitur akuzë kundër të akuzuarit L.A për shkak të veprave penale posedimi i paautorizuarit narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së. Prokurori e shtetit ka bërë rikualifikimin e veprave penale në vazhdim konform dispozitave të nenit 81 të KPRK-së pasi që janë plotësuar kushtet ligjore që i akuzuari ka kryer këto vepra penale në vazhdim.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 26.12.2018, në të cilën shqyrtim prokurori i shtetit mbeti pranë kualifikimit juridik të veprës penale dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim te paraparë me ligj.

I akuzuari L.A, në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë duke shprehur pendim për veprimin e kryer dhe ka kërkuar nga Gjykata që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh rrethanat se në kohën e përdorimit të këtyre substancave ka qenë në spitalin psikiatrik në Prishtinë “RSV- Antidroge” i cili ka bërë pastrimin e gjakut dhe ka qëndruar 17 ditë dhe pasi që është baba i dy fëmijëve, i premtan gjykatës se më nuk do të përsëris vepra të tilla apo të ngjashme dhe e lutë gjykatën ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 të KPPK-ës:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë vërtetimin mbi sekuestrimin të përkohshëm të sendeve me numër 2018-DHTN-538 të datës.21.06.2018, Raporti i testit fushor nga Drejtoria për hetimit të trafikimit me narkotik si dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjesorti i ekspertizës i datës 29.05.2018, Raporti i oficerit të datës 29.05.2017,e kaluara kriminale të dhënat nga SIPK dhe shkresat tjera që gjenden në lende.

Duke vlerësuar në aspektin juridik Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit L.A ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale posedimi i paautorizuarit narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sikurse me datë, kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin L.A Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka bërë pranimin fajësisë, babai i dy fëmijëve përkatësisht mbajtës i familjes, i gjendjes së dobët ekonomike, kurse në rastin konkret si rrethana rënduese mori se i njëjti ka qenë i dënuar edhe me parë për vepra të tilla penale dhe atë me nr.P.1128/18 i datës 28.09.2018 dhe P.919/18 i datës 27.07.2018, e po ashtu vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Në rastin e shqiptimit të dënimit Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë përkatësisht me aplikimin e institutit të zbutjes së dënimit, nën minimumin e paraparë ligjor nga 1 (një) vite në 6 (gjashtë) muaj burgim në kuptim të nenit 75 par. 1 dhe 1.3 të KPK-së duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale kanë bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve të paraparë në nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 273 par.5 të KPRK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë 4.21 gram.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 25/njëzet e pesë/€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 /tridhjetë/€ në afat prej 30 ditëve, nga data kur aktgjykimi merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr. 987/18 me 09.01.2019**

**Praktikante**  
**Marigona Shaqiri**

**Gjyqtari,**  
**Hakile Ilazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.